



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCEVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E THESARIT

24.12.8  
Nr. ....Prot.

27.12  
Tirane, me .....2011

**Per:** **Banken e Shqiperise**  
Alpha Bank  
Intesa SanPaolo Bank  
Banken Credins  
Raiffeisen Bank  
Banken e Pare te Investimeve  
Banken Kombetare te Greqise  
Banken Nderkombetare Tregtare  
Banken Popullore-Societa Generale  
Banken Tregtare te Greqise  
Banken Kombetare Tregtare  
Pro Credit Bank  
Banken e Bashkuar te Shqiperise  
Tirana Bank  
Union Bank  
Veneto Bank

Drejtorene e Pergjithshme te Tatimeve  
Drejtorene e Pergjithshme te Doganave  
Institutin e Sigurimeve Shoqerore  
Institutin e Sigurimeve te Kujdesit Shendetsor

Ministrine/Institucionin Qendror \_\_\_\_\_  
(Buxhet/Finance dhe Njesive te Zbatimit te Projekteve-Financ. Huaj)

TIRANE

Drejtorene e Pergjithshme te Buxhetit

KETU

Degen e Thesarit \_\_\_\_\_

**Subjekti:** **Procesimi i transaksioneve te fundvitit.**

Referuar nenit 38 te ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë": "Ministri i Financave nxjerr urdhra, udhëzime dhe rregullore ne baze dhe për zbatim te këtij ligji" dhe ne vijim te Udhezimit Nr.4, date 27.01.2011, "Per Zbatimin e Buxhetit te vitit 2011", pikes 7.1, paragrafit 135 "Mbyllja e Buxhetit te vitit 2011" per transaksionet e fundvitit te ndiqet procedura e meposhtme:

1. Buxheti i shtetit i vitit 2011 rakordohet ne nivel grupi, titulli, kapitulli e artikulli, përfshi edhe limitin e perdorimit te te ardhurave te institucioneve buxhetore nga Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit (DPB) prane Ministrise se Financave me ministrite e linjes.

Degët e Thesarit per arketimet e vitit 2011 ne favor te institucioneve te qeverisjes se pergjithshme (fonde te cilat ne zbatim te legjislacionit perdoren nga njesia e qeverisjes se pergjithshme dhe trashegohen ne vitin 2012), kryejne procesin e alokimit te ketyre fondeve ne sistemin AMoFTS (Albanian Ministry of Finance Treasury System) ne strukturat buxhetore ku duhet te perdoren brenda dates 05.01.2011 ne baze te akt-rakordimit te mbajtur midis deges se Thesarit dhe njesise se qeverisjes se pergjithshme.

Perdorimi i cdo fondi buxhetor do te behet sipas procedurave te percaktuara per menaxhimin e cash-it.

2. Ne zbatim te paragrafit 135 te udhezimit nr.4, date 27.01.2011 "Per zbatimin e buxhetit te shtetit te vitit 2011", njesite e qeverisjes se pergjithshme do te paraqesin dokumenta per pagese ne degen e Thesarit deri ne daten 12.12.2011 per shpenzimet operative/kapitale dhe deri ne daten 17.12.2011 per paga, kontribute te sigurimeve shoqerore/shendetsores, ndihma ekonomike dhe paaftesi (sipas urdherit nr. Date 2011). Per shkak te volumit te madh te dokumentacionit te paraqitur, dega e Thesarit do ti rregjistroje ne sistemin AMoFTS deri ne daten 23.12.2011, pervec rasteve te urdheruara posacerisht.
3. Degët e Thesarit rakordojnë paraprakisht me njesite e qeverisjes se pergjithshme te dhenat e raportimeve vjetore qe paraqesin ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit (DPTH) sipas formatit te gjeneruar nga sistemi AMoFTS.  
Ne rastet e konstatimeve te gabimeve te rregjistrimeve ne sistem te shkresave te ndryshimit te planit ne nivel vjetor te Buxhetit te Shtetit te vitit 2011 t'i raportojne si te tilla ne DPB dhe DPTH, te cilat bejne sistemimet perkatese. Per cdo mosperputhje te ketyre planeve ne nivel programi, kapitulli, artikulli do te behen sistemimet me DPB, e cila pergatit akt-rakordimin paraprak elektronik (duke komunikuar me e-mail) me Ministrite e Linjes/Institucionet Qendrore per planin perfundimtar te vitit 2011 deri ne daten 16.01.2012 (duke filluar procesin e rakordimit prej dates 17.12.2011 me perfundimin e paraqitjes se dokumentacionit per shpenzim ne degët e Thesarit).
4. Ne kuadrin e raportimit te treguesve fiskale buxhetore me ane te sistemit AMoFTS, raportimet vjetore te shpenzimeve dhe te ardhurave te gjeneruara nga moduli "accrual" (mbi baze te drejtash dhe detyrimesh te konstatuara) dhe "cash" (mbi baze arketimesh dhe pagesash) te paraqitura ne DPTH duhet te jene te konfirmuara (firme/vule) zyrtarisht nga specialistet perkates te deges se Thesarit, pergjegjesi i deges se Thesarit dhe personat e autorizuar per rakordim te njesise se qeverisjes se pergjithshme (ne momentin e paraqitjes se pageses se pagave, te cilat do te procesohen ne sistem pas konfirmimit te te dhenave buxhetore te vitit 2011 nga njesia shpenzuese/arketuese). Kjo perben domosdoshmeri (te dhenat duhet te jene shume te sakta dhe te rakorduara me pergjegjesi te plote nga stafi i zbatimit te buxhetit), pasi raportimet vjetore te konfirmuara do te sherbejne si akt rakordime per trashegimet ne vitin pasardhes ne sistemin AMoFTS.

Per cdo pasaktesi do te aplikohen masa administrative ne zbatim te legjislacionit.

5. Bankat e nivelit te dyte kryejne arketime per llogari te vitit 2011 deri ne daten 31.12.2011. Llogarite bankare te buxhetit do te fillojne me gjendje zero ne vitin 2011. Te mos behet asnje ndryshim lidhur me numrat e llogarive te buxhetit te shtetit, pasi ato jane tashme te rregjistruara ne sistemin AMoFTS.  
Degët e Thesarit përfundojnë rakordimin me Bankat e Nivelit te Dyte dhe raportojne ne DPTH brenda dates 05.01.2011.  
Sistemimet te cilat nuk kane ndikim ne balancen e Qeverise do te kryhen nga vete Deget e Thesarit dhe Deget e Bankave te Nivelit te Dyte pa konfirmim nga DPTH.  
Permbledheset per sistemimet te cilat kane ndikim ne balancen e Qeverise do te paraqiten ne DPTH prane Ministrise se Financave deri ne daten 06.01.2011 dhe do te kryhen me urdher te Ministrit te Financave.  
DPTH do te dergoje pagesa elektronike ne Banken e Shqiperise deri me daten 29.12.2011, pervec rasteve te urdheruara posacerisht.
6. Degët e Thesarit përfundojnë rakordimin me Degët e Tatimeve dhe Doganave dhe raportojne ne DPTH brenda dates 09.01.2012.
7. Degët e Thesarit dorëzojnë raportin përfundimtar te te ardhurave e shpenzimeve buxhetore ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit brenda datës 10.01.2012.
8. Njësite e Projekteve me Financime te Huaja, ISSH e ISKSH dorëzojnë raportin përfundimtar te te ardhurave e shpenzimeve ne DPTH brenda datës 10.01.2012. Raporti i Financimeve te Huaja te gjeneruar nga sistemi AMoFTS duhet te jete i konfirmuar zyrtarisht nga DPTH dhe Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit (DPB).
9. DPTH pergatit brenda dates 10.01.2012 raportin përfundimtar te te ardhurave dhe shpenzimeve te llogarisë bankare "Depozite e Qeverise" te konfirmuar nga Banka e Shqiperise.
10. Drejtoritë e Bankave te nivelit te dyte konfirmojne sipas formatit te sistemit AMoFTS raportin vjetor mbi arkëtimet e njesive te qeverise se pergjithshme deri ne datën 11.01.2012.
11. DPTH dërgon për konfirmim aktrakordimin përfundimtar për te ardhurat e shpenzimet e vitit 2011 ne Bankën e Shqipërisë brenda datës 11.01.2012. Banka e Shqiperise konfirmon te dhenat e fundvitit deri me 12.01.2012. Ne rast mosperputhje behen sistemimet e mundshme deri me 13.01.2012, date ne te cilen Ministri i Financave, me propozim te DPTH, miraton sistemimet per vitin 2011.
12. DPTH dhe Drejtoria e Teknologjisë se Informacionit publikon te dhënat faktike (te detajuara ne nivel njësie shpenzuese sipas struktures buxhetore mbi baze "accrual" dhe "cash") ne faqen e Internetit brenda datës 16.01.2012, te cilat do te shërbejnë për rakordim te raportit vjetor te shpenzimeve dhe te ardhurave për vitin 2011 nga çdo ministri dhe institucion qendror.
13. Ministritë dhe Institucionet Qendrore deri ne datën 19.01.2011 paraqesin fillimisht ne DPTH mospërputhjet me situacionet përfundimtare te njesive shpenzuese (te konfirmuar nga Degët e Thesarit). Pas kalimit te këtij afati, ne rast moskonfirmimi, merren te mirëqena te dhënat faktike te publikuara ne faqen e Internetit. ([www.minfin.gov.al](http://www.minfin.gov.al))
14. Kur ka raste te shpenzimeve mbi ose jashtë planit, mbahet proces-verbal midis palëve rakorduese. Ne raste te argumentuara, për efekt te rakordimit dhe kur veprimi nuk sjell pasoja financiare, bëhen sisteme nga DPB, pas miratimit nga Ministri i Financave.

15. DPTH përgatit të dhenat faktike të raportit fiskal përfundimtar brenda datës 23.01.2011.
16. Në sistemin AMoFTS është bërë rregjistrimi i gjendjes së aktiveve të qëndrueshme të mbartura më 01.01.2011. Gjate muajit Janar të vitit 2012, në zbatim të procedurës (manualit) të rregjistrimit, rakordimit dhe raportimit të të dhenave (përfshirë edhe ato të procesuara jashtë sistemit AMoFTS) të aktiveve të qëndrueshme do të procesohet me transaksionet e vitit 2011 që do të mbarten gjendje në vitin 2012 (do të perdoret periudha 13-2011 për kontabilizim). Në fund të muajit Janar të vitit 2012 do të gjenerohet nga sistemi AMoFTS raporti i "Gjendjes financiare" të njësive së qeverisjes së përgjithshme (që përmban të gjitha transaksionet e aktiveve të qëndrueshme), i cili pas rakordimit do të konfirmohet (firmë/vule) zyrtarisht nga specialistet përkatës të degës së Thesarit, përgjegjësi i degës së Thesarit dhe personat e autorizuar për rakordim të njësive së qeverisjes së përgjithshme (nuk do të procesohet me pagesat e pagave në muajin Shkurt të vitit 2012 në rast mosparaqitje në degen përkatëse të Thesarit me përjashtim të rasteve objektive për defekte teknike etj.).
17. Në sistemin AMoFTS është bërë rregjistrimi i gjendjes së debitorëve, kreditorëve dhe inventarit të mbartura më 01.01.2011. Gjate muajit Janar të vitit 2012, në zbatim të procedurës (manualit) të rregjistrimit, rakordimit dhe raportimit të të dhenave (përfshirë edhe ato të procesuara jashtë sistemit AMoFTS) të debitorëve, kreditorëve dhe inventarit do të procesohet me transaksionet e vitit 2011 që do të mbarten gjendje në vitin 2012 (do të perdoret periudha 13-2011 për kontabilizim). Në fund të muajit Janar të vitit 2012 do të gjenerohet nga sistemi AMoFTS raporti i "Gjendjes financiare" të njësive së qeverisjes së përgjithshme (që përmban të gjitha transaksionet e debitorëve, kreditorëve dhe inventarit), i cili pas rakordimit do të konfirmohet (firmë/vule) zyrtarisht nga specialistet përkatës të degës së Thesarit, përgjegjësi i degës së Thesarit dhe personat e autorizuar për rakordim të njësive së qeverisjes së përgjithshme (nuk do të procesohet me pagesat e pagave në muajin Shkurt të vitit 2012 në rast mosparaqitje në degen përkatëse të Thesarit me përjashtim të rasteve objektive për defekte teknike etj.).
18. Deri në fund të muajit Mars Deget e Thesarit do të gjenerojnë nga sistemi AMoFTS pasqyrat financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në "accrual" dhe "cash", të cilat pas rakordimit do të konfirmohen (firmë/vule) zyrtarisht dhe nuk do të procesohet me pagesat e pagave në muajin Prill të vitit 2012 në rast mosparaqitje në degen përkatëse të Thesarit me përjashtim të rasteve objektive për defekte teknike etj.) nga specialistet përgjegjës të degës së Thesarit, përgjegjësi i degës së Thesarit dhe personat e autorizuar për rakordim të njësive së qeverisjes së përgjithshme.

Kjo përben domosdoshmëri, pasi trashëgimet në vitin pasardhës do të behen automatikisht nga sistemi AMoFTS, prandaj të dhenat duhet të jenë shumë të sakta dhe të rakorduara me përgjegjësi të plote nga stafi kontabel. Për çdo pasaktësi do të aplikohen masa administrative në zbatim të legjislativës në fuqi.

19. Raporti përfundimtar i gjendjes faktike të shpenzimeve dhe të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit i paraqitet Këshillit të Ministrave brenda muajit Maj të vitit 2012 dhe pas shqyrtimit të tij, i dërgohet për miratim Kuvendit brenda muajit Qershor të vitit 2012.

20. Pas miratimit nga Kuvendi, DPTH, DPB, Drejtoria e Përgjithshme e Makroekonomisë dhe Drejtoria e Teknologjise së Informacionit pranë Ministrisë së Financave përgatisin Statistikat Financiare të Qeverisë (buletinin vjetor dhe tabelat (GFS) sipas standardeve ndërkombëtare të përcaktuara nga FMN) brenda datës 30.06.2012.
21. Me fillimin e vitit të ri buxhetor 2012 faturat e papaguara nga viti 2011 do të rregjistrohen nga degët e Thesarit me datë 03.01.2012 për të pakesuar planin buxhetor 2012 pasi janë detyrime të prapambetura dhe do të paguhën me prioritet, pas pagesës së pagave, kontributeteve të sigurimeve shoqërore/shëndetsore, tatimeve mbi të ardhurat personale dhe ndihmes ekonomike/papunesise.
22. Rregjistrimi i urdherave të blerjes në sistemin e Thesarit do të bëhet menjëherë me nënshkrimin e saj nga palet kontraktuese dhe data e rregjistrimit do të bëjë objekt auditimi i dokumentacionit të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme. Dega e Thesarit me rregjistrimin e urdher blerjes në sistem do të verë në dokumentin origjinal vëllën dhe datën e rregjistrimit, e cila do të kontrollohet me datën e faturimit/eve të mevonshme.
- Në fund të vitit, nëse kontrata nuk realizohet (është me status "hapur" në sistemin AMoFTS dhe përmban shuma të palidhura me fature shpenzimi), atëherë anulohet nga sistemi i Thesarit me konfirmimin e paleve kontraktuese dhe nuk mbartet në vitin e ri buxhetor. Nëse nuk anulohet nga palet kontraktuese, atëherë do të mbartet automatikisht nga sistemi në vitin pasardhës 2012.
- Deri në datën 30.12.2011 degët e Thesarit duhet të kenë rakorduar me njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe konfirmuar në sistem statusin ("mbyllur" apo "hapur") të urdherave të blerjes, në zbatim të rregullave të udhëzimit për hapat ditore në sistem.
23. Pagesat për shpenzime operative dhe kapitale do të paguhën elektronikisht deri në 30 ditë vonese nga data e rregjistrimit në sistemin AMoFTS.
24. Do të aplikohen gjoha nga 1-3 rroga mujore mbi të gjithë specialistët e degëve të Thesarit që rregjistrojnë fatura (qoftë edhe gabimisht) me datë përpara datës së paraqitjes së tyre në Thesar, pasi shkaktojnë artificialisht krijimin e detyrimeve të prapambetura në sistem.
25. Plani i Thesarit do të detajohet në muaj sipas parashikimit financiar të likuiditetit nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit mbi bazën e propozimit të ministrive të linjes.
26. Degët e tatimeve dhe të doganave në datën 25 të çdo muaji do të sjellin në DPTH parashikimin për arketimet e muajit pasardhës për menaxhimin e cash-it.
27. Pagesa e pagave të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme do të shpërndahet në të gjitha ditët në muajt për një menaxhim me efektivitet të likuiditetit.
28. Bankat e nivelit të dytë në fund të çdo dite do të raportojnë (me e-mail) në degët e Thesarit postën ditore sipas furnitoreve (të tretëve) të paguar prej tyre. Degët e Thesarit do të ndjekin shlyerjen e debitoreve nga bankat e nivelit të dytë dhe do të raportojnë për çdo vonese në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për të respektuar kushtet e marrëveshjes me bankat e nivelit të dytë.
- Për të gjitha kthimet e pagesave elektronike që janë për shkak (i) të instruksioneve të gabuara nga plotësimi i dokumentacionit të paraqitur në Thesar nga njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, pagesa e komisionit bankar do të bëhet prej fondeve operative të këtyre të fundit me iniciativë të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në bazë të procesverbalit të mbajtur midis njësive shpenzuese dhe degës së Thesarit. Në rast se kthimet e pagesave janë për shkak (ii) të rregjistrimit të gabuar

nga specialisti i deges se Thesarit, atehere pagesa e komisionit do te mbahet nga paga e specialistit. Nese kthimi i pageses eshte per arsye te (iii) gabimeve nga banka e nivelit te dyte, atehere nuk do te paguhet komision, por me banken perkatese do te mbahet proces verbal per mosrespektimin e kushteve te marreveshjes.

Per te gjitha rastet e instruksioneve te gabuara, banka e nivelit te dyte ben kthimin menjchere te pageses se gabuar ne Llogarine Unike te Thesarit per tu proceduar me korrigjimin nga degjet e Thesarit ne bashkepunim me njesite shpenzuese.

Te procedohet menjëherë.

**Ridvan BODE**

  
**MINISTER**